



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 167/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk “Firdeus Security Group” shpk, “Res 03” shpk dhe “S.S.X” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-40235-01-11-2018, me objekt: “Shërbim me Roje Private” – *Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj*”, me fond limit 6,335,996.90 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 22.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ballazhi” shpk “Siguria” shpk “Dea Security” shpk, “Firdeus Security Group” shpk “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Oktapus” shpk “Toni Security” shpk, si dhe lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomik “Oktapus” shpk “Toni Security” shpk dhe “Snajper Security” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Autoriteti kontraktor: Instituti i Shëndetit Publik.
Adresa: Rruga “Aleksandër Moisiu” Nr. 80, Tiranë.

Ankimues “Start 2000” shpk
Adresa: Rruga “Budi”, Nr. 19, Tiranë.

“S.S.X” shpk
Adresa: Rruga “5 Maj”, brënda ish – ndërmarjes kimike, Tiranë.

“Eurogjici Security”
Adresa: Rruga “Adem Jashari”, Lagjia nr. 8, Hyrja nr. 10, Ap nr. 3, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e

prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.01.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-40235-01-11-2018, me objekt: “Shërbim me Roje Private” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 6,335,996.90 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 22.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik.

II.2 Në datën 01.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

1. “Rozafa 94” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
2. “Arbana” SH.A	Pa ofertë	skualifikuar
3. “Eurogjici Security”	12962 lekë	skualifikuar
4. “Internacional Security Albania”	15741.90 lekë	skualifikuar
5. “Ballazhi”	17359.09 lekë	skualifikuar
6. “Safe”	17359.09 lekë	skualifikuar
7. “Dea Security”	17359.13 lekë	kualifikuar
8. “Cullhaj”	17359.13 lekë	kualifikuar
9. “Firdeus Security”	17359.13 lekë	kualifikuar
10. “Nazeri 2000”	17359.24 lekë	kualifikuar
11. “Firdeus Security Group”	17359.35 lekë	kualifikuar
12. “Toni Security”	17362.39 lekë	skualifikuar
13. “Oktapus”	17362.41 lekë	skualifikuar
14. “Res 03”	17362.41 lekë	kualifikuar
15. “Snajper Security”	17362.64 lekë	skualifikuar
16. “S.S.X”	17362.65 lekë	kualifikuar
17. “Start 2000”	17362.69 lekë	kualifikuar
18. “N.S.S”	17369.51 lekë	skualifikuar
19. “Trezhnjeva” shpk	6193595.31 lekë	skualifikuar

20. "Pelikani Security Group"	6193685.12 lekë	skualifikuar
21. "Ales"	6193690.21 lekë	skualifikuar
22. "Aulona-Pol 1"	6193690.21 lekë	skualifikuar
23. "Myrto Security"	6193690.21 lekë	skualifikuar
24. "G.S.E Security"	6335996.35 lekë	skualifikuar
25. "Leksi Security"	6335996.47 lekë	skualifikuar

II.3. Në datën 05.02.2018, operatori ekonomik "Start 2000" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomik "Dea Security" shpk, "Cullhaj" shpk, "Firdeus Security" shpk, "Nazeri 2000" shpk "Firdeus Security Group" shpk, "Res 03" shpk dhe "S.S.X" shpk, në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

"Autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik, më datë 22.01.2018, zhvilloi procedurën e tenderimit, "Kërkesë për Propozim", me objekt "Ruajtja me roje private" e ambjentëve të ISHP-së" Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të papërcaktuara – me afat 12 muaj me fond limit 6,335,996.90 lekë pa tvsh. Operatori ynë ekonomik sipas kërkesës në DST për shërbimin e kërkuar, paraqiti ofertën ditore me vlerë prej 17362.69 lekë. Më datë 01.02.2018 në faqen elektronike të APP-së, Ak ka publikuar vlersimin e ofertave të operatorëve. Oferta e operatorit ekonomik është pranuar si ofertë e vlefshme. Operatori ynë ekonomik vëren se lisat e shpallur e vlersimit nga Ak, ka oferta ekonomike të pranuar me vlerë më të vogël dhe jo ligjore.

Më Konkretisht janë këto oferta të operatorëve:

1. "Dea Security"	17359.13 lekë
2. "Cullhaj"	17359.13 lekë
3. "Firdeus Security"	17359.13 lekë
4. "Nazeri 2000"	17359.24 lekë
5. "Firdeus Security Group"	17359.35 lekë
6. "Res 03"	17362.41 lekë
7. "S.S.X"	17362.65 lekë

Theksojmë se:

Operatori ynë ekonomik në përgatitjen e ofertës ekonomike ka zbatuar të gjitha detyrimet ligjore dhe më konkretisht veprimet arithmetike të kryera janë:

- Paga bazë minimale është 36000 lekë
- Paga orare është 36000/174 orë = 206.89 lekë
- Shtesa për turnin e II (dytë) është 758.01 lekë
- Shtesa për turnin e III (tretë) është 5053.43 lekë

Kemi: 36000 lekë + 758.01 lekë + 5053.43 lekë = 41811.44 lekë

*Sigurimet shoqërore (16.7%) janë: 41811.44 lekë * 16.7% = 6982.51 lekë*

Pagë + sigurime: 41811.44 lekë + 6982.51 lekë = 48793.95 lekë për një roje në muaj.

*Për një vëndroje me 4.98 roje kemi: 48793.95 lekë * 4.98 roje = 242933.871 lekë në muaj.
Për një ditë nevojiten: 242993.871/30.41 ditë = 7990.59 lekë pa tvsh për 1 v/r ditore, kjo shumëzuar me 2 v/r sipas kërkesës së shërbimit është 15981.18 lekë dhe vlera për një v/r turni parë që është: 42012/30.41 = 1381.51 lekë.*

Kemi 7990.59 + 7990.59 +1381.51 = 17362.69 lekë. Pra vlera e përgjithshme ditore për shërbimin e kërkuar është 17362.69 lekë. Theksojmë se kjo mënyrë llogaritje është e saktë dhe ligjore. Operatori ynë ekonomik thekson se jemi para një veprimi të gabuar arithmetik të operatorëve “Dea Security” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Firdeus Security Group” shpk, “Res 03” shpk dhe “S.S.X” shpk, që ka sjellë dhe ofertimin me vlerë më të vogël dhe jo ligjore”.

II.3.1. Në datën 09.02.2018, me shkresën nr. 37/21 prot, operatori ekonomik “Start 2000” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.3.2. Në datën 13.02.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “Start 2000” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.4. Në datën 05.02.2018, operatori ekonomik “S.S.X” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomik “Ballazhi” shpk, “Siguria” shpk “Dea Security” shpk, “Firdeus Security Group” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Oktapus” shpk, “Toni Security” shpk, dhe kërkon lënien të skualifikuar operatorët ekonomik “Oktapus” shpk dhe “Toni Security” në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Në datë 01.02.2018, shoqëria “S.S.X” shpk u njoh me njoftimin e klasifikimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim me roje private” i ambjenteve të ISHP-së Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë përcaktuara me afat 12 muaj. Duke qënë se vlerësimi i ofertave është bërë në kundërshtim me LPP dhe RrPP, atëherë, në zbatim të nenit 63, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenit 78 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, po paraqesim këtë formular ankesë pranë autoritetit kontraktor si shkalla e parë e ankimit kërkojmë skualifikimin e ofertave të këtyre OP, “Ballazhi” shpk, “Siguria” shpk “Dea Security” shpk, “Firdeus Security Group” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Oktapus” shpk, dhe “Toni Security” shpk, si oferta nën kosto minimale ligjoredhe që nuk kanë respektuar detyrimet minimale si pagën pazë minimale, shtesat për turnin e II-të dhe të III-të, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore.

Përlllogaritja konkrete për çmimin për njësi çmimi për një vëndroje në ditë:

*Paga = 36000 lekë * 4.98 roje : 30.41 roje = 5895.42 lekë*

Shtesa turnit II (dytë) = 206.89 lekë * 20% * 3 orë = 124.13 lekë

Shtesa turnit III (tretë) = 206.89 lekë * 50% * 8 orë = 827.56 lekë

Sigurime shoqërore dhe shëndetsore = 6847.11 lekë * 16.7 % = 1143.46 lekë

Totali = 7990.57 lekë pa tvsh për 1 (një) v/r në ditë.

Përlllogaritja konkrete për cmimin për njësi – cmimipër një vëndroje në ditë:

Paga = 36000 lekë * 1 roje : 30.41 roje = 1183.82 lekë

Sigurime shoqërore dhe shëndetsore = 1183.82 lekë * 16.7% = 197.69 lekë

Totali = 1381.51 lekë pa tvsh për 1 (një) v/r në ditë.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar

I Përlllogaritja për një vëndroje me tre turne

Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me tre turne /dite
1	Shpenzime per page baze		
2	Shtese mbi page per turn II		
3	Shtese mbi page per turn III		
4	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore 16.7%		
Vlera totale pa TVSH per nje roje ne dite			
Vlera totale me TVSH per 1 roje ne dite			

II Përlllogaritja për 1 vëndroje pozicion gjatë orarit zyrtar

Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me nje turn(turn i pare) /dite
1	Shpenzime per page baze		
2	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore		
Vlera totale pa TVSH per nje roje ne dite			
Vlera totale me TVSH per 1 roje ne dite			

- Operatoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperem, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399,

datë 3.5.2017, ” Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

- *Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me tre turne të llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*

Këto oferta nuk kanë respektuar detyrimet ligjore për pagën bazë, shtesat turni II, shtesat turni III si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore pra nuk kanë respektuar asnjë zë të preventivit ditor për të dyja vendrojet.

Gjithashtu kërkojmë që statusi i ofertave të operatorëve ekonomik “Toni Security” shpk, “Oktapus” shpk dhe “Snajper Security” të mbetet i refuzuar me të njëjtin argumentim pra si oferta nën kosto minimale ligjore.

II.4.1. Në datën 09.02.2018, me shkresën nr. 37/30 prot, operatori ekonomik “S.S.X” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.4.2. Në datën 19.02.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “S.S.X” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt anekese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. . Operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k., më datë 01.02.2018, është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit si më poshtë vijon:

“Skualifikohet pasi nuk ka paraqitur Shtojcën nr. 4 të DST-ve, ku ofertuesi duhet të deklaronte për ekstraktin dhe të tjera. Subjekti skualifikohet sepse nuk ka paraqitur Shtojcën nr. 4 të DST-ve. Skualifikohet pasi nuk ka paraqitur Shtojcën nr. 4 të DST-ve.”

II.5.1. Në datën 05.02.2018 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

“Në lidhje me arsyen e skualifikimit gjykojmë se shoqëria “Eurogjici Security” shpk, ka plotësuar të gjitha kriteret që përmbanin dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: “Ruajtja me roje private e ambjenteve të ISHP-së”

Së pari në shtojcën 4 një nga pikat që ka kërkuar autoriteti kontraktor është:

Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme

- *Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

Në lidhje me këtë kriter shoqëria ka paraqitur “Ekstraktin e thjeshtë dhe historik” me datë 03.01.2018 që është dokumenti bazë dhe i rëndësishëm për të provuar që operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv). Gjykojmë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme provueshmëria me fakte dhe e dokumentuar e kërkesës së mësipërme, dokument i cili është lëshuar nga autoritetet kompetente, e cila plotësohet dhe përmbushet nga operatori ekonomik dhe mendojmë se ky prevalon përpara një vetdeklarate me shkrim., pasi të jep informacionin e duhur. Për sa më sipër mendojmë se ky fakt duhet të merrtë parasysh nga autoriteti kontraktor, duke qënë se vërtetohet dhe provohet se operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) dhe mbi të gjitha autoriteti nuk mund të bëjë një gjykim sipërfaqësor.

Së dyti në shtojcën 4 një nga pikat që ka kërkuar autoriteti kontraktor është:

- *Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Edhe në lidhje me këtë kriter shoqëria jonë ka paraqitur vërtetimin për pagim detyrimesh nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM me Nr T00086562, datë 17.01.2018, e cila provon dhe fakton se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër mendojmë se ky fakt duhet të merrtë parasysh nga autoriteti kontraktor duke qënë se vërtetohet dhe provohet se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

II.5.2. Në datën 09.02.2018, me shkresën nr. 37/26 prot, operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.5.3. Në datën 19.02.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Me shkresën nr. 187/12 prot, datë 20.02.2018, protokolluar me tonën me nr. 232/2 prot, datë 21.02.2018, shkresën nr. 187/16 prot, datë 28.02.2018, protokolluar me tonën me nr. 274/2 prot, datë 01.03.2018 dhe me shkresën nr. 187/15 prot, datë 28.02.2018, protokolluar me tonën me nr. 281/2 prot, datë 01.03.2018, me objekt “Informacion” është depozituar në Komisionin e

Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Start 2000” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomik me arsyen se: [...] Shoqërite “Dea Security” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Firdeus Security Group” shpk, “Res 03” shpk dhe “S.S.X” shpk, Operatori ynë ekonomik thekson se jemi para një veprimi të gabuar arithmetik të këtyre operatorëve ekonomik që ka sjellë dhe ofertimin me vlerë më të vogël dhe jo ligjore [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas

shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.1.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta. Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomikë – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.1.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimes duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.1.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t’i kërkohej të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se oferta e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, në pjesën “Sqarim”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

Sqarime:

1. Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Shqiptare (lekë)
2. Në çmim duhet të jenë të përfshirë të gjithë detyrimet që parashikon kuadri ligjor.

3. Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertes të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Përlllogaritja për një vendroje me tre turne

Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për page baze		
2	Shtese mbi page për turn II		
3	Shtese mbi page për turn III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetsore 16.7%		
Vlera totale pa TVSH për një roje në ditë			
Vlera totale me TVSH për 1 roje në ditë			
II Përlllogaritja për 1 vendroje pozicion gjatë orarit zyrtar			
Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me një turn(turn i parë) /dite
1	Shpenzime për page baze		
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetsore		
Vlera totale pa TVSH për një roje në ditë			
Vlera totale me TVSH për 1 roje në ditë			

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me tre turne të llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).

- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

III.1.9. Ndërkohë në shtojcën 7/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 7 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

“7. Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizen e kostos per oferten e paraqitur. (Shih Shtojca I - Sqarime).”

III.1.10. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Numri i vendrojeve do të jetë sic është specifikuar në termat e referencës.

Një vend roje do të jetë pranë portës qendrore të ISHP-së(për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike).

Një vend roje tjetër do të jetë pranë Vivariumit që mbulon edhe Qendrën e trajnimit (për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike).

Një vend do të jetë në derën e godinës katërkatëshe kryesore të Institutit të Shëndetit Publik (në turn vetëm paradite 08,00-16,30 për shërbim nga e Hëna në të Premte, vetëm gjatë orarit zyrtar). Pjesa tjetër e kohës për këtë vend roje do të mbulohet nga vend Roja e portës qendrore të ISHP-së.

Public Health Sector

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve sipas vendrojeve. Vendroja e turnit të dytë të portës qendrore do të marrë dorëzimin për shërbimin edhe për godinën kryesore të ISHP-së e cila do ti pasohet edhe turnit të tretë i cili ky i fundit duhet t’ia dorëzojë rojes së turnit të parë të godinës qendrore të ISHP-së për ditët javore të punës dhe rojes së turnit të parë tek porta kryesore për ditët e pushimit javor, si dhe festat.

III.1.11. Ndërsa në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: Objekti “Shërbim me Roje private” në ambientet e Institutit të Shëndetit Publik, me adresë : RR. Aleksandër Mosiu, Nr.80, Tiranë – Marrveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj.

Shërbimi do të kryhet për 24 orë në ditë për të gjitha ditët kalendarike duke përfshirë dhe ditën e shtunë dhe të djelë për dy vend roje, ndërsa për vend rojen vetëm të turnit të parë shërbimi do të jetë nga e hëna në të premten dhe nga ora 08,00 deri ne 16,30 dhe për festa pushim .

Pjesa tjetër e kohës për këtë vend roje do të mbulohet nga roja e portës qendrore të ISHP-së ashtu edhe për ditët e pushimit javor.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar).

Vendndodhja e shërbimit: Instituti i Shëndetit Publik Tiranë

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
2	3	9.96	12 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.
1	1 (turn i pare)	1	12 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.1.12. Në shtojcën 11 “*Termet e Referencës*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Ruajtja e ambienteve të Institutit të Shëndetit Publik - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 12 muaj.

Detyrat: Ruajtja e ambienteve duke perfshirë të gjitha godinat që janë brenda terriotrit të Institutit të Shëndetit Publik.

Shpërndarja: Një vend roje do të jetë pranë portës qendrore të ISHP-së (për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike) .

Një vend roje tjetër do të jetë pranë Vivariumit që mbulon edhe Qendrën e trajnimit (për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike) .

Një vend do të jetë në derën e godinës kryesore katërkatëshe të Institutit të Shëndetit Publik (në turn vetëm paradite 08,00-16,30 për shërbim nga e hëna në të premte). Pjesa tjetër e kohës për këtë vend roje do të mbulohet nga vend Roja e portës qendrore të ISHP-së.

Në të gjitha vendrojet e sipërcituara shërbimi duhet te kryhet me armë sipas ligjislacionit në fuqi.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve sipas vendrojeve. Vendroja e turnit të dytë të portës qendrore do të marrë dorëzimin për shërbimin edhe për godinën kryesore të ISHP-së e cila do ti pasohet

edhe turnit të tretë i cili ky i fundit duhet t'ia dorëzojë rojes së turnit të parë të godinës qendrore të ISHP-së për ditët javore të punës dhe rojes së turnit të parë tek porta kryesore për ditë
4.Vendi i kryerjes së shërbimeve: Institutit të Shëndetit Publik

III.1.13. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore, si dhe gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë; si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën e parashikuar nga ligji. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni vëren se operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit, përkatësisht për 1 roje /ditë, për 1 vendroje me një turnë (turni parë), si dhe për 1 vendroje me tre turne/ditë- në përputhje me dokumentat e tenderit; ndërkohë që dhe vlerësimi dhe renditja e ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO është kryer gjithashtu mbi bazën e analizës së kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesit, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë “Dea Security” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Firdeus Security Group” shpk, “Res 03” shpk dhe “S.S.X” shpk, konkretisht elementëve bazë (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) – elementë këto të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST. Për sa më sipër K.P.P, gjykon se operatorët ekonomikë “Dea Security” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Firdeus Security Group” shpk, “Res 03” shpk dhe “S.S.X” shpk, kanë respektuar dispozitat ligjore për pagën bazë minimale, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit, sic është bërë edhe vlerësimi i ofertave nga ana e autoritetit kontraktor.

Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatorët ekonomikë “Dea Security” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Firdeus Security Group” shpk, “Res 03” shpk dhe “S.S.X” shpk, kanë përmbushur detyrimet bazë për një oferte të sukseshme, siç janë llogaritja saktë e pagës bazë, shtesave mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën dhe vlerat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Start 2000” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “S.S.X” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve “Ballazhi” shpk, “Siguria” shpk, “Dea Security” shpk “Firdeus Security Group” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, dhe “Nazeri 2000” shpk me arsyen se [...] *Shoqërite “Ballazhi” shpk, “Siguria” shpk, “Dea Security” shpk “Firdeus Security Group” shpk, “Cullhaj” shpk, “Firdeus Security” shpk, dhe “Nazeri 2000” shpk, janë oferta nën koston minimale ligjore dhe që nuk kanë respektuar detyrimet minimale si pagën bazë minimale ligjore, shtesat për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, si dhe lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomik “Oktapus” shpk “Toni Security” shpk dhe “Snajper Security” shpk [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”*.

III.2.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: *“1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:*

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.2.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.2.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta. Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomik – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.2.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimes duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë

me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.2.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit

të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t’i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, në pjesën “Sqarim”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

Sqarime:

4. Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Shqiptare (lekë)
5. Në çmim duhet të jenë të përfshirë të gjithë detyrimet që parashikon kuadri ligjor.
6. Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Përlllogaritja për një vëndroje me tre turne

Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me tre turne /dite
1	Shpenzime per page baze		
2	Shtese mbi page per turn II		
3	Shtese mbi page per turn III		
4	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore 16.7%		
Vlera totale pa TVSH per nje roje ne dite			
Vlera totale me TVSH per 1 roje ne dite			
II Përlllogaritja për 1 vëndroje pozicion gjatë orarit zyrtar			
Nr.	Emertimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me nje turn(turn i pare) /dite
1	Shpenzime per page baze		
2	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore		
Vlera totale pa TVSH per nje roje ne dite			
Vlera totale me TVSH per 1 roje ne dite			

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vëndroje me tre turne të llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*

III.2.9. Ndërkohë në shtojcën 7/2, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 7 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

“7. Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizen e kostos per oferten e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime).”

III.2.10. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Numri i vendrojeve do të jetë sic është specifikuar në termat e referencës.

Një vend roje do të jetë pranë portës qendrore të ISHP-së(për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike).

Një vend roje tjetër do të jetë pranë Vivariumit që mbulon edhe Qendrën e trajnimit (për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike).

Një vend do të jetë në derën e godinës katërkatëshe kryesore të Institutit të Shëndetit Publik (në turn vetëm paradite 08,00-16,30 për shërbim nga e Hëna në të Premte, vetëm gjatë orarit zyrtar). Pjesa tjetër e kohës për këtë vend roje do të mbulohet nga vend Roja e portës qendrore të ISHP-së.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve sipas vendrojeve. Vendroja e turnit të dytë të portës qendrore do të marrë dorëzimin për shërbimin edhe për godinën kryesore të ISHP-së e cila do ti pasohet edhe turnit të tretë i cili ky i fundit duhet t’ia dorëzojë rojes së turnit të parë të godinës qendrore të ISHP-së për ditët javore të punës dhe rojes së turnit të parë tek porta kryesore për ditët e pushimit javor, si dhe festat.

III.2.11. Ndërsa në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: Objekti “Shërbim me Roje private” në ambientet e Institutit të Shëndetit Publik, me adresë : RR. Aleksandër Mosiu, Nr.80, Tiranë – Marrveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë tëpërcaktuara me afat 12 muaj.

Shërbimi do të kryhet për 24 orë në ditë për të gjitha ditët kalendarike duke përfshirë dhe ditën e shtunë dhe të djelë për dy vend roje, ndërsa për vend rojen vetëm të turnit të parë shërbimi do të jetë nga e hëna në të premten dhe nga ora 08,00 deri ne 16,30 dhe për festa pushim .

Pjesa tjetër e kohës për këtë vend roje do të mbulohet nga roja e portës qendrore të ISHP-së ashtu edhe për ditët e pushimit javor.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar).

Vendndodhja e shërbimit: Instituti i Shëndetit Publik Tiranë

<i>Numri i Vendrojeve</i>	<i>Numri i turneve</i>	<i>Numri i rojeve te nevojshme</i>	<i>Afati i levrimit</i>
2	3	9.96	12 muaj

			<i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.</i>
1	1(turn i pare)	1	12 muaj <i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.</i>

III.2.12. Në shtojcën 11 “*Termet e Referencës*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: *Ruajtja e ambienteve të Institutit të Shëndetit Publik - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 12 muaj.*

Detyrat: *Ruajtja e ambienteve duke perfshirë të gjitha godinat që janë brenda terriortrit të Institutit të Shëndetit Publik.*

Shpërndarja: Një vend roje do të jetë pranë portës qendrore të ISHP-së (për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike).

Një vend roje tjetër do të jetë pranë Vivariumit që mbulon edhe Qendrën e trajnimit (për tre turne shërbimi 24 orë për gjithë ditët kalendarike).

Një vend do të jetë në derën e godinës kryesore katërkatëshe të Institutit të Shëndetit Publik (në turn vetëm paradite 08,00-16,30 për shërbim nga e hëna në të premte). Pjesa tjetër e kohës për këtë vend roje do të mbulohet nga vend Roja e portës qendrore të ISHP-së.

Në të gjitha vendrojet e sipërcituara shërbimi duhet te kryhet me armë sipas ligjislacionit në fuqi.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve sipas vendrojeve. Vendroja e turnit të dytë të portës qendrore do të marrë dorëzimin për shërbimin edhe për godinën kryesore të ISHP-së e cila do ti pasohet edhe turnit të tretë i cili ky i fundit duhet t’ia dorëzojë rojes së turnit të parë të godinës qendrore të ISHP-së për ditët javore të punës dhe rojes së turnit të parë tek porta kryesore për dit

4.Vendi i kryerjes së shërbimeve: Institutit të Shëndetit Publik

III.2.13. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore, si dhe gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha

parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë; si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën e parashikuar nga ligji. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni vëren se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit, përkatësisht për 1 roje /ditë, për 1 vendroje me një turnë (turni parë), si dhe për 1 vendroje me tre turne/ditë- në përputhje me dokumentat e tenderit; ndërkohë që dhe vlerësimi dhe renditja e ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO është kryer gjithashtu mbi bazën e analizës së kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesit, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë *“Dea Security” shpk*, *“Cullhaj” shpk*, *“Firdeus Security” shpk*, *“Nazeri 2000” shpk*, *“Firdeus Security Group” shpk*, konkretisht elementëve bazë (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) – elementë këto të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST. Për sa më sipër K.P.P, gjykon se operatorët ekonomikë *“Dea Security” shpk*, *“Cullhaj” shpk*, *“Firdeus Security” shpk*, *“Nazeri 2000” shpk*, *“Firdeus Security Group” shpk*, kanë respektuar dispozitat ligjore për pagën bazë minimale, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit, sic është bërë edhe vlerësimi i ofertave nga ana e autoritetit kontraktor.

Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatorët ekonomikë *“Dea Security” shpk*, *“Cullhaj” shpk*, *“Firdeus Security” shpk*, *“Nazeri 2000” shpk*, *“Firdeus Security Group” shpk*, kanë përmbushur detyrimet bazë për një oferte të sukseshme, siç janë llogaritja saktë e pagës bazë, shtesave mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën dhe vlerat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik *“S.S.X” shpk* nuk qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik *“S.S.X” shpk* për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës, *“Ballazhi” shpk*, *“Toni Security” shpk*, *“Oktapus” shpk* dhe *“Snajper Security” shpk*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 01.02.2018, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më

tepër, nga verifikimi i kryer nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të kenë paraqitur ankesë në KPP në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “S.S.X” shpk për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës “Ballazhi” shpk, “Toni Security” shpk, “Oktapus” shpk, dhe “Snajper Security” nuk do të merret në shqyrtim.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “S.S.X” shpk për operatorin ekonomik “Siguria” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik pas verifikimit në sistemin elektronik të prokurimeve për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-40235-01-11-2018, me objekt: “Shërbim me Roje Private” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 6,335,996.90 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 22.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik, vëren se operatori ekonomik “Siguria” shpk nuk është pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “S.S.X” shpk për operatorin ekonomik “Siguria” shpk nuk do të merret në shqyrtim.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyen se [...]Në lidhje me këtë kriter shoqëria ka paraqitur “Ekstraktin e thjeshtë dhe historik” me datë 03.01.2018 që është dokumenti bazë dhe i rëndësishëm për të provuar që operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv). Gjykojmë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme provueshmëria me fakte dhe e dokumentuar e kërkesës së mësipërme, dokument i cili është lëshuar nga autoritetet kompetente, e cila plotësohet dhe përmbushet nga operatori ekonomik dhe mendojmë se ky prevalon përpara një vetdeklarate me shkrim., pasi të jep informacionin e duhur. Për sa më sipër mendojmë se ky fakt duhet të merrët parasysh nga autoriteti kontraktor, duke qënë se vërtetohet dhe provohet se operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) dhe mbi të gjitha autoriteti nuk mund të bëjë një gjykim sipërfaqësor. Së dyti në shtojcën 4 një nga pikat që ka kërkuar autoriteti kontraktor është:

“Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi”. Edhe në lidhje me këtë kriter shoqëria jonë ka paraqitur vërtetimin për pagim detyrimesh nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM me Nr T00086562, datë 17.01.2018, e cila provon dhe faktin se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Për sa më sipër mendojmë se ky fakt duhet të merrët parasysh nga autoriteti kontraktor duke qënë se vërtetohet dhe provohet se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në Shtojcën 4 “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar si më poshtë:

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Nënshkrimi _____

Public Health Sector

III.5.2. Në Shtojcën 7 pika 1 “Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar si më poshtë:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

III.5.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) në përmbushje të kriterit të sipërcituar rezulton se operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k nuk ka paraqitur Shtojcën 4 “*Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme*”.

III.5.4. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...]Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]”

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; **Public Health Sector**

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.5.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, thuhet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.5.6. Në Vendimin Nr. 01 datë 10.01.2018, “Për Miratimin e Dokumentave Standarte të Tenderit për Procedurën “Kërkesë për Propozim’ për Furnizimin e Mallrave, Shërbimeve dhe Kryerjen e Punëve”, Agjencia e Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të miratojë setin e Dokumentave Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, për kontratat e furnizimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve publike, bashkalidhur këtij vendimi;*
2. *Autoritetet Kontraktore në hartimin e dokumentave të tenderit për procedurën konkrete duhet të ngarkojë në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm ato formularë, pjesë e setit standard, të cilat shërbejnë për objektin konkret të procedurës së prokurimit;*
3. *Ngarkohen autoritetet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.*

Ky vendim publikohet në faqen e APP-së në datë 10.01.2018 dhe hyn në fuqi menjëherë.

III.5.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, më konkretisht Agjencia e Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2018, ka miratuar setin e dokumentave standarte të tenderit ku në pikën 3 të këtij vendimi, ngarkohen autoritetet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi. Operatorët ekonomikë kanë detyrimin ligjor të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Pra autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k nuk plotësohet kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e Shtojcën 4 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, e cila është pjesë e dokumentatve standarte të tenderit e miratuar me Vendimin Nr. 01.10.2018, të Agjencisë së Prokurimit Publik, dhe shprehimisht citohet se plotësimi i saj është detyrim për operatorët ekonomik, ashtu dhe siç është kërkuar në dokumentat e tenderit si më sipër cituar. Ankimuesi në parashtrimet e tij në ankesë e pranon mungesën fizike të këtij dokumenti kur shprehet se “Gjykojmë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme provueshmëria me fakte dhe e dokumentuar e kërkesës së mësipërme, dokument i cili është lëshuar nga autoritetet kompetente, e cila plotësohet dhe përmbushet nga operatori ekonomik dhe mendojmë se ky prevalon përpara një vetdeklarate me shkrim., pasi të jep informacionin e duhur”.

Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u

ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këtë kontekst edhe operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k kishte detyrimin ligjor të plotësonte kërkesën e autoritetit kontraktor në përputhje me nenin 46 të LPP-së si më sipër cituar. Në rast se ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues, do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

III.5.8. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Start 2000” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-40235-01-11-2018, me objekt: “Shërbim me Roje Private” – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 6,335,996.90 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 22.01.2018, nga autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “S.S.X” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
4. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 232 Protokoli; Datë 13.02.2018

Nr. 274 Protokoli; Datë 19.02.2018

Nr. 281 Protokoli; Datë 19.02.2018

Public Health Sector

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha